



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-4240/20 datë:18.02.2020



Npi – 01/59 datë: 27.02.2020

Bazuar në nenin 40.2. pika (d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Si dhe në bazë të Neneve 6 pika 1.1, Nenit 9 të Udhëzimit Administrativ të MPB, Nr.27/2012 dhe MAPL, Nr.03/2012, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi; Nenin 10.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për Transparencë në Komuna Nr.04/2018; Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna Nr.06/2018; Kuvendi i Komunës së Shitimes në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
PROPOZIM-PLANIN E PUNËS TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI PËR VITIN 2020

I

Kuvendi Komunës së Shitimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 27.02.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Propozim-Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020 në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj